Në tubimin e aktivistëve të PDSH – së të mbajtur më 18.07.2017 në Preshevë, u shqyrtua situata e krijuar në Partinë Demokratike Shqiptare, dhe per opinion nxjerrë këtë:

KOMUNIKATË

Për simpatizantët e PDSH – së është e njohur situata e krijuar në PDSH – në, para dhe pas zgjedhjeve të Dhjetorit të vitit 2016. Gjithashtu është e njohur se gjatë këtyre zgjedhjeve u cenua rëndë demokracia e brendshme partiake, që do të thotë se nuk u respektuan procedurat e parapara me statut dhe rregullore të partisë. Andaj mendojmë se organet e dalura nga ky kuvend zgjedhor nuk janë meritore për perfaqësimin e gjithëmbarshëm të elektorit të PDSH – së, dhe bëmë çdo përpjekje për të dalë nga kjo situatë shumë e rëndë partiake.

Nga ky tubim bëjmë me dije antarsinë, simpatizantët dhe aktivistët e PDSH - së të cilët mendojnë ndryshe nga ajo që përfaqëson grupimi politikë rrethë Ragmi Mustafës, se ne jemi të hapur dhe i mirëpresim të gjithë ata që mendojnë të rrugëtojnë ndryshe. Nuk do të lejojmë që bashkëmendimtarët t'i lëmë pa zgjidhje dhe për këtë jemi të gatshëm (në mungesë të marrëveshjes) të rrugëtojmë të pavarur, në mënyrë që t'i japim mundësinë atyre që mendojnë si NE. Jemi të gatshëm për një organizim ku do të ketë demokraci të brendshme, aty ku do të respektohet mendimi ndryshe dhe kontributi i të gjithëve. Organizim në të cilin nuk do të ketë vend për falcifikatorë, nuk do të ketë vend për manipulatorë dhe për ata të cilët në politikë hynë për tu pasuruar.

Shkelja e dokumenteve partiake dhe mos lejimi i reformave partiake solli si rezultat pamundësinë e rrugëtimit të përbashkët të partisë. Ne mendojmë se PDSH – re meriton një rrugëtim të vërtetë demokratikë, e në rradhë të parë reformues. Andaj do të mundohemi që REFORMA të jetë permanente dhe vlerë që do të synohet të bëhet praktikë e partisë. Në kuader të kësaj qasje reformuese vend të veçantë do të kenë kuadrot e reja partiake.

Nga kjo qasje ftojmë të gjithë të rinjtë dhe të rejat e Komunës së Preshevës dhe më gjërë që ta ndihmojnë këtë rrugëtim politik. Ne PDSH – ja Reformuese jemi të bindur se qasja jonë është progresiste nga fakti se ka karakter reformues, ka frymë rinore, bashkëpunim me të gjithë kurse bashkëveprim me idenjejtit. Jemi garancë për përparimin e shqiptarëve të Luginës.

Në Preshevë, 18.07.2017

Nga Këshilli Inicues i
PDSH-së Reformuese

Scanned by CamScanner